

GRIGORE BRÂNCUȘ



(1929–2022)

Më 2 prill 2022 u nda nga jeta prof. Grigore Brâncuș, një nga gjuhëtarët më të shquar rumunë, anëtar titullar i Akademisë së Shkencave të Rumanisë. Grigore Brâncuș kreu studimet në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Bukureshtit më 1953 dhe filloi punën në katedrën e gjuhës rumune, ku dha mësim deri më 1999. Veprimtaria e tij shkencore shtrihet në një varg fushash të romanistikës, si historia e gjuhës rumune, dialektologjia, leksikologjia, filologjia, toponimia e antroponimia, historia e gjuhës letrare, stilistika, dhe përfshin gjuhën rumune në të gjitha etapat e evolucionit të saj. Ndihmesa të rëndësishme ka sjellë edhe në trajtimin e shumë çështjeve të rumanishtes në vështrimin e saj si gjuhë e romanitetit lindor dhe ballkanike. Ishte një nga specialistët më të mirë në studimin e problemeve të substratit të rumanishtes, vështruar në krahasim me gjuhën shqipe

Gr. Brâncuș është autor i një vargu veprash reference dhe studimesh të tjera, ndër të cilat: “Limba română contemporană. Morfologia

verbului” (“Gjuha rumune. Morfologjia e foljes”), “Vocabularul autohton al limbii române” (“Leksiku autokton i gjuhës rumune”), “Istoria cuvintelor. Unitate de limbă și cultură românească” (“Historia e fjalëve. Njësia e gjuhës dhe e kulturës rumune”), “Introducere în historia limbii române” (“Hyrje në historinë e gjuhës rumune”), “Cercetări asupra fondului traco-dac al limbii române” (“Kërkime për fondin trako-dak të gjuhës rumune”), “Concordançe lingvistice româno-albaneze” (“Përkime gjuhësore rumuno-shqipe”), si edhe i shumë artikujve në revista shkencore. Ka marrë pjesë edhe në hartimin e fjalorit shumëvëllimësh të gjuhës rumune, të ndërmarrë nga Akademia e Shkencave e Rumanisë. Më 2006 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave të Rumanisë dhe më 2011 anëtar titullar. Në vitet e fundit të jetës qe drejtor nderi i Institutit të Gjuhësisë “Iorgu Iordan – Alexandru Rosetti” të Akademisë së Shkencave të Rumanisë.

Gr. Brâncuș ka dhënë ndihmesa të shquara në fushën e dialektologjisë së rumanishtes, duke i vështruar të dhënat e dialekteve edhe nga marrëdhënia e tyre me gjuhën letrare e me gjuhën popullore në përgjithësi, por edhe në lidhje me kulturën materiale e shpirtërore, me antroponiminë dhe me toponiminë. Atë e tërhoqi gjithashtu struktura gramatikore e rumanishtes dhe struktura e leksikut, sidomos nga pikëpamja e komponenteve themelore të tij. Solli ndihmesa të rëndësishme edhe në fushën e gjuhës letrare rumune, duke vlerësuar në një dritë të re studimet e disa përfaqësuesve të shquar të gjuhësisë dhe filologjisë rumune.

Një rrethanë fatlume për karrierën shkencore të Gr. Brâncuș-it ishte përkrahja nga ana e akademikut Alexandru Rosetti, shefi i katedrës dhe njëkohësisht dekan i Fakultetit të Filologjisë, të cilin ai e përmendte si shembull të fisnikërisë intelektuale dhe të dashamirësisë ndaj të rinjve që hynin plot vullnet dhe besim në rrugën e vështirë të kërkimit shkencor. Al. Rosetti (1895–1990), i mirënjohur në rrethet gjuhësore europiane e më gjerë, një ndër figurat e shquara dhe me autoritet shoqëror të shkencës e kulturës rumune, njeri me vizionin e së ardhmes, përkrahës i risive shkencore dhe i të rinjve, pati idenë largpamëse që të dërgonte disa nga asistentët e tij për specializim në universitete të huaja. Kështu, Gr. Brâncuș erdhi në Tiranë më 1959 për të mësuar gjuhën shqipe dhe për një specializim në albanologji. Gjatë atij qëndrimi studimor njëvjeçar ai jo vetëm mësoi mirë gjuhën shqipe (arriti të lexonte “Mesharin” e Buzukut) dhe hyri në atmosferën e punëve të gjuhësisë shqiptare, por edhe u njoh nga afër me gjuhëtarët shqiptarë më në zë të asaj kohe, ndër të cilët Aleksandër Xhuvanin

(1880–1961), Eqrem Çabejn (1908-1980), Mahir Domin (1915–2000), që ishin kolegë të çmuar dhe miq të përzemërt e të afërt të Al. Rosetti-t. Falë lidhjeve miqësore ndërmjet këtyre gjuhëtarëve të shquar shqiptarë dhe kolegëve të tyre në Rumani, gjuhësia rumune u bë më e njohur në Shqipëri dhe gjuhëtarët shqiptarë përfituan mjaft nga përvoja e saj. Më vonë Gr. Brâncuș u dërgua për dy vjet si lektor i rumanishtes në Universitetin e Amsterdemit dhe të Gröningenis, ku u njoh nga afër edhe me drejtimet e reja të studimeve gjuhësore në Europën Perëndimore. Ky “investim shkencor” i Al. Rosetti-t i dha shpejt frytet e veta. Me Gr. Brâncuș-in studimet shqiptare në Rumani mund të thuhet se hynë në një fazë të re. Nga njëra anë, thellohen kërkimet e mëparshme të elementeve të përbashkëta a të ngjashme ndërmjet dy gjuhëve, të vëna re prej kohësh; nga ana tjetër, zgjerohet interesimi i gjuhëtarëve rumunë për shqipen si gjuhë ballkanike, për historinë e saj dhe për veçoritë e strukturës së saj gramatikore e fonetike. Gjithashtu gjuha shqipe filloi të mësohej me një kurs të posaçëm universitar nga Gr. Brâncuș.

Në fillimet e veprimtarisë kërkimore Gr. Brâncuș iu kushtua studimit përqasës të strukturave frazeologjike e semantike të rumanishtes dhe shqipes, duke ravijëzuar me këtë mënyrë karakterin e veçantë të rumanishtes ndërmjet gjuhëve romane, po edhe ndërmjet gjuhëve të Ballkanit. Një vend të rëndësishëm në këtë veprimtari zënë hulumtimet e tij për marrëdhëniet e hershme ndërmjet rumanishtes e shqipes dhe interpretimi i elementeve të përbashkëta të tyre në leksik, fonetikë e gramatikë, që përbëjnë një nga temat më tërheqëse të studimit për historinë e këtyre dy gjuhëve në periudhën e Antikitetit të vonë e të Mesjetës së hershme (nga rënia e Perandorisë Romake deri në shek. IX–X). Më 1966 Gr. Brâncuș erdhi sërish në Shqipëri për një anketë gjuhësore te arumunët, gjatë së cilës, siç është shprehur vetë, mbledhi materiale për të hetuar fatin e fjalëve autoktone të rumanishtes në të folmet arumune të Shqipërisë.

Në bibliografinë e botimeve të Gr. Brâncuș-it studimet për marrëdhëniet gjuhësore ndërmjet shqipes e rumanishtes zënë një vend me rëndësi dhe përbëjnë një fushë hulumtimesh të përqendruara e të hollësishme. Veprat kryesore të tij në këtë fushë janë “Vocabularul autohton al limbii române” (1983), “Cercetări asupra fondului trac-dac al limbii române (1995), Concordanțe lingvistice româno-albaneze” (1999), Studii de istorie a limbii române (2007, 2008, 2013). Për botimin shqip të “Cercetări asupra fondului traco-dac al limbii române” autori shkroi një parathënie të posaçme, ku, duke e vështruar, nga lartësia e

një përvoje 50-vjeçare, problematikën e marrëdhënieve ndërmjet shqipes e rumanishtes dhe të pozitës së këtyre dy gjuhëve në ansamblin ballkanik, ka formuluar disa vlerësime e konstatime të përgjithshme, që mund të përmbliidhen në pikat e mëposhtme. *Së pari*: afria ndërmjet rumanishtes dhe shqipes nuk rrëgjohet (reduktohet) vetëm te një numër i caktuar fjalësh, por përfshin të gjitha strukturat e gjuhës: fonetikë, morfologji, sintaksë, frazeologji, fjalëformim. *Së dyti*: krahas afrisë gjuhësore të të dy popujt vërehet një mendësi e përbashkët e ndërtuar në kohë në bazë të përvojave të njëjta historike, vërehen elemente të përbashkëta në fushën e kulturës e të qytetërimit popullor, të folklorit, mitologjisë e të artit popullor. *Së treti*: në ansamblin ballkanik rumanishtja dhe shqipja (e para gjuhë e grupit roman, e dyta gjuhë e izoluar në familjen indoeuropiane) përbëjnë një grup më vete, që karakterizohet nga misteri i formimit të afrisë së tyre. *Së katërti*: shpjegimi i elementeve të përbashkëta e të ngjashme të të dy gjuhëve përmes një huazimi të kryer vonë në mënyrë të ndërsjellë apo nga një drejtim i vetëm duket i pamjaftueshëm për gjerësinë e shtrirjes së tyre në të gjitha strukturat e gjuhës; së këtejmi, më afër së vërtetës qëndron hipoteza që ngjashmëritë ndërmjet shqipes dhe rumanishtes i shpjegon nga një gjuhë e tretë, e cila flitej në hapësirën e tyre në kohën pararomake (e ashtuquajtura *teori e substratit*). Për këtë hipotezë të substratit E. Çabej ka vërejtur se ndërkaq ajo që vlen si substrat për rumanishten si gjuhë romane, për gjuhën shqipe nuk është gjë tjetër veçse një fazë shumë e hershme e historisë së saj.

Lidhur me argumentet gjuhësore të burimit të shqipes nga kjo ose ajo gjuhë e Ballkanit të lashtë (trakishtja ose ilirishtja), Gr. Brâncuș është shprehur me të drejtë se materiali i ruajtur prej tyre është aq i varfër, “saqë lejon të parashtrohet çdo hipotezë”, prandaj ai, si të thuash, e shpëput këtë çështje nga ajo e trajtimit të elementeve të përbashkëta të shqipes dhe rumanishtes. Por synimi për të gjetur medoesmos shpjegimin përfundimtar të dukurisë, nuk duhet ta shmangë studiuesin nga detyra e përshkrimit dhe e hulumtimit të vetë ngjashmërive mbi një material sa më të pasur e të besueshëm.

Është e njohur se shqipja dhe rumanishtja me tiparet e tyre karakteristike të përbashkëta a të ngjashme përbëjnë boshtin e Lidhjes Gjuhësore Ballkanike, që bart jo pak enigma të pazbërthyera. Duke iu referuar H. Pedersenit, prof. E. Çabej thoshte me këtë rast se detyra e gjuhëtarit është jo aq të tregojë sa *janë* gjuhët të ngjashme ndërmjet tyre, po sa *janë bërë* të ngjashme. Kjo detyrë nuk duhet lënë pas dore kur studiohen marrëdhëniet ndërmjet gjuhëve ballkanike, veçanërisht

marrëdhëniet e rumanishtes me shqipen; këtu parimi statik duhet të zëvendësohet me parimin dinamik evolutiv. Lidhur me këtë Gr. Brâncuș ka meritën e veçantë se me studimet e tij e ka pasuruar në mënyrë të ndjeshme materialin rreth kësaj teme dhe ka treguar karakterin vërtet kompleks të saj.

Duhet përmendur dashamirësia dhe vlerësimi që akademiku Gr. Brâncuș ruajti deri në fund të jetës për kolegët shqiptarë e për Shqipërinë dhe roli i tij për ta bërë më të njohur gjuhën shqipe dhe gjuhësinë shqiptare në Fakultetin e Filologjisë, ku punoi gjysmë shekulli, si edhe ndër gjuhëtarët rumunë në përgjithësi. Një nga nxënëset e tij, Dr. Cătălina Vătășescu, punonjëse shkencore në Institutin e Studimeve të Europës Juglindore (Bukuresht), duke ecur në rrugën e mjeshtrit të saj, ka sjellë ndihmesa të shumta e të rëndësishme në studimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet shqipes e rumanishtes, ndërmjet shqipes e latinishtes në përjasje me rumanishten, dhe të një numri çështjesh të historisë së brendshme të shqipes.

Akademiku Gr. Brâncuș zë një vend nderi në historinë e pasur të albanologjisë rumune, humbja e tij do të ndihet gjatë, kujtimi i tij dhe vlerat e punës së tij do të ruhen edhe më gjatë.

Emil LAFE